



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 22.09.2016

Ref.:875/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 45-të, të mbajtur më 22 Shtator 2016, mori:

V E N D I M

- I. Programet e studimit në gjuhën minoritare (Boshnjake dhe Turke) në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës të ofruara deri me tani, të cilat kanë mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është përcaktuar më Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016), neni 11, pika 3.2.), lejohen të ofrohen paralelisht me programet e akredituara në gjuhën shqipe, me kusht që brenda periudhës kalimtare prej pesë (5) viteve, këto institucione të ngrisin kapacitete vetanake të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e ofrimit të programit të studimit, sipas kërkesave të përcaktuara më Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016), neni 11, pika 3.2.).
- II. Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren i lejohet të ofroj programet e studimit:
 - Programi Fillor, BA, 240 ECTS, (Gjuhë Turke dhe Gjuhë Boshnjake);
 - Programi Parafillor, BA, 240 ECTS, (Gjuhë Turke dhe Gjuhë Boshnjake);
 - Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, (Gjuhë Turke dhe Gjuhë Boshnjake).
- III. Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë i lejohet të ofroj programet e studimit:
 - Menaxhment në Turizëm, BA, 180 ECTS, (në Gjuhën Boshnjake).
- IV. Gjitha procedurat dhe kriteret e tjera të përcaktuara për akreditimin e programeve të studimit zbatohen sipas legjislacionit në fuqi.
- V. Ky vendimi vlen për programet e studimit të cekura më sipër nga viti akademik 2016/2017.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsy e t i m i


Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren me datën 16.09.2016 (nr. 496/16) ka parashtruar kërkesë tek Agjencia e Kosovë për Akreditim për lejin e ofrimit të programeve të studimit në gjuhën boshnjake dhe turke.

Ndërkohë, edhe Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë me datë 20.09.2016 (nr.502/16) ka parashtruar kërkesë tek Agjencia e Kosovë për Akreditim për lejin e ofrimit të programeve të studimit në gjuhën boshnjake.

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 11, pika 3.3, sipas të cilës: *"Programet e studimit në gjuhët e komuniteteve (boshnjake dhe turke) në universitetet publike të Republikës së Kosovës të ofruara deri më tani, të cilat kanë mungesë të stafit akademik me gradën Dr. Sc., ashtu siç është përcaktuar me këtë UA, do të lejohen të ofrohen paralelisht me programet e akredituara në gjuhën shqipe, me kusht që brenda periudhës kalimtare prej pese (5) viteve, këto institucione të ngrisin kapacitete vetanake të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e ofrimit të programit të studimit, sipas kërkesave të mësipërme të këtij UA",* KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Ukshin Hoti";
- Universitetit "Haxhi Zeka";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë